



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.492/1Prot.

Tiranë, më 17/03/2021

V E N D I M

Nr. 46, Datë 17/03/2021

Mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 99, datë 18.09.2020, e Qendrës “Konsumatori Shqiptar”, ku pretendohet diskriminim i banorëve arumunë të Grabovës, për shkak të etnisë, nga ana e Bashkisë Gramsh.

Pas shqyrtimit të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar shpjegimeve të dhëna në ankesë, Grabova e Poshtëme dhe e Sipërme janë pjesë e Njësisë Administrative Lenie, ku kjo e fundit është pjesë e Bashkisë Gramsh. Në ankesë theksohet fakti se në Grabovë mungon infrastruktura rrugore, që lidh Lenien me Grabovën, shkolla, ku mësojnë 60 fëmijë të kësaj zone, është në prag shembjeje, ujësjellësi është zgjidhur në mënyrë artizanale nga ana e banorëve të zonës dhe urat e vjetra që rrethojnë fshatin janë shëmbur. Në ankesë theksohet fakti se një situatë e tillë po e çon zonën e Grabovës drejt izolimit. Grabova ka të gjitha vlerat dhe karakteristikat e një zone turistike malore, por të gjitha mangësitë e mësipërme pengojnë mundësinë për t’u shfrytëzuar si e tillë. Banorët shprehen se nuk kanë kushtet minimale për të jetuar, duke filluar nga infrastruktura rrugore, për të cilën pretendohet se nuk është rikonstruktuar asnjëherë, ndërkohë që rrugët e fshatrave të tjerë janë rikonstruktuar disa herë. Problematika paraqet shërbimi i ujësjellës-kanalizimeve, për cilin theksohet fakti se nuk mungojnë kanalizimet për ujërat e zeza, si dhe nuk ofrohet shërbimi i ujit të pijshëm. Problematikat vazhdojnë edhe më tej, lidhur me Qendrën Shëndetësore, e cila ndodhet në qendër të fshatit në mes të një pellgu me ujë, që përbën burim infeksioni, pasi nuk ekzistojnë kanalizimet përkatëse. Banorët ankohen gjithashtu lidhur me ndriçimin e ambienteve publike i

cili mungon etj. Qendra “Konsumatori Shqiptar” pretendon diskriminim etnik të banorëve të Grabovës, pasi Bashkia Gramsh nuk ka plotësuar përgjegjësitë e saj ligjore, duke mos u ofruar shërbimet bazike për të jetuar. Shoqata pretendon se kjo ka ndodhur, pasi këta të fundit i përkasin pakicave arumune që jetojnë në Shqipëri.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në datën 18.11.2020, kanë hyrë në fuqi ndryshimet ligjore, të miratuara me ligjin nr. 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”¹. Meqënëse çështja objekt i këtij shqyrtimi administrativ është paraqitur përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 124/2020, atëherë Komisioneri vlerëson se çështja duhet të shqyrtohet sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të pandryshuar.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “c”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”², që i jep të drejtën për të hetuar dhe shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Ligji nr.10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 3, i Ligjit nr.10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Ndërsa, në Kreun II, të ligjit parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të tij parashikon se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo

¹ Ligji nr.124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, është botuar në Fletoren Zyrtare Nr.191, datë 03.11.2020.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi. 2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: a) mundësi për të hyrë në një vend ku publiku lejohet të hyjë ose për të përdorur një vend, i cili lejohet për t'u përdorur nga publiku; b) mundësi për të marrë ose për të përfutur nga të mirat apo shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin... etj.”

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 99, datë 18.09.2020, të Qendrës “Konsumatorit Shqiptar”, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” (i ndryshuar). Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” (i ndryshuar), Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Bashkisë Gramsh me shkresën nr. 1259/1, datë 08.10.2020, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
 1. Informacion mbi faktin, nëse banorët e Grabovës furnizohen me ujë të pijshëm nëpërmjet sistemit të ujës-jellës kanalizimeve, si dhe nëse këta banorë janë të pajisur me matësat përkatës;
 2. Informacion nëse në zonën e Grabovës ekzistojnë kanalizimet për ujërat e zeza;
 3. Informacion mbi gjendjen infrastrukturore të shkollës dhe qendrës shëndetësore së Grabovës;
 4. Informacion mbi faktin nëse Bashkia Gramsh ka siguruar ndriçimin e ambienteve publike në zonën e Grabovës;
 5. Informacion mbi infrastrukturën rrugore të kësaj zone dhe gjendjen e saj.

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t'u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

6. Informacion mbi investimet e kryera gjatë 3 viteve të fundit nga ana e Bashkisë Gramsh në zonën e Grabovës, lidhur me infrastrukturën rrugore, ofrimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm, ndërtimin apo rikonstruksionin e institucioneve arsimore, qendrave shëndetësore dhe urave;
7. Informacion mbi investimet që janë kryer në fshatrat fqinjë, lidhur me sa më sipër, në krahasim me zonën e Grabovës.

- Në përgjigje të shkresës nr. 1259/1, datë 08.10.2020, së Komisionerit, Bashkia Gramsh dërgoi shkresën nr. 3889/1, datë 16.10.2020, nëpërmjet së cilës sqaron se realisht infrastruktura rrugore në Grabovë nuk është e mirë, sikurse në pjesën më të madhe të zonave rurale në Bashkinë Gramsh. Pavarësisht kësaj, në vitin 2018, Bashkia Gramsh realizoi konstruktimin e rrugës Kratë-Lenie-Grabovë Sipër me vlerë 3.679.936 lekë, ku e pajisi rrugën me vepra arti (tombino) dhe zhavorrim. Me buxhetin e Bashkisë Gramsh është e pamundur të asfaltohen të gjithë rrugët e 94 fshatarave në territorin që mbulon kjo bashki.

Pretendimet e banorëve të Grabovës se shkolla e fshatit është në prag shembjeje nuk qendrojnë, pasi në vitin 2018, Bashkia Gramsh rikonstrukttoi shkollën 9-vjeçare “Koli Baba” në fshatin Grabovë Sipër me vlerë 11.323.252 lekë.

Njëkohësisht, Bashkia Gramsh sqaron se është rikonstruktuar ura në qendër të fshatit dhe është bërë drenazhimi i qendrës së fshatit. Aktualisht, nuk ka pellg me ujë në afërsi të Qendrës Shëndetësore, i cili mund të jetë burim infeksioni.

Bashkia Gramsh, jo vetëm që nuk e ka diskriminuar asnjëherë fshatin Grabovë, por krenohet me bukurinë dhe vlerat kulturore, historike dhe etnike të kësaj zone. Pavarësisht, pamundësisë së bashkisë për asfaltimin e rrugës së fshatit Grabovë, ky institucion sqaron se është munduar ta promovojë Grabovën si një nga qytetërimet më të hershme shqiptare, e cila nuk duhet lënë pa vizituar.

2. Në vijim, Komisioneri iu drejtua sërish Bashkisë Gramsh, nëpërmjet shkresës nr. 1259/3, datë 21.10.2020, ku i kërkon të disponojë në cilësi prove dokumentacionin përkatës, që vërteton, si më poshtë vijon:

1. Kryerjen e investimit për rikonstruktimin e infrastrukturës rrugore Kuratë-Lenie – Grabovë, në vitin 2018;
2. Kryerjen e investimit për rikonstruktimin e shkollës së fshatit Grabovë, në vitin 2018;
3. Kryerjen e investimit për rikonstruktimin e urës në qendër të fshatit Grabovë;
4. Drenazhimin e pellgut me ujë në afërsi të Qendrës Shëndetësore Grabovë;

Njëkohësisht, Komisioneri kërkoi që Bashkia Gramsh të japë informacion edhe mbi disa nga çështjet, që janë cituar në shkresën nr. 1259/1, datë 08.10.2020, por nuk janë dërguar të dhënat përkatëse, si më poshtë vijojnë:

1. Informacion mbi faktin, nëse banorët e Grabovës furnizohen me ujë të pijshëm nëpërmjet sistemit të ujësjellës kanalizimeve, si dhe nëse këta banorë janë të pajisur me matësat përkatës;
 2. Informacion nëse në zonën e Grabovës ekzistojnë kanalizimet për ujërat e zeza;
 3. Informacion mbi faktin nëse Bashkia Gramsh ka siguruar ndriçimin e ambienteve publike në zonën e Grabovës;
 4. Informacion mbi investimet që janë kryer në fshatrat fqinjë, përgjatë 3 viteve të fundit, në krahasim me zonën e Grabovës.
- Në përgjigje të shkresës nr. 1259/3, datë 21.10.2020, të Komisionerit, Bashkia Gramsh dërgoi shkresën nr. 3889/3, datë 27.10.2020, nëpërmjet së cilës informon mbi çështjet e mëposhtëme:
1. Për investimin *“Rikonstruksion i rrugës Lenie-Kuratë-Grabovë e Sipërme, Njësia Lenie”* dërgohet bashkëlidhur Kontrata e Sipërmarrjes dhe Çertifikata e Përkoshme e Marrjes në Dorëzim të Punimeve;
 2. Për investimin *“Rikonstruksion i Shkollës 9-vjeçare Koli Baba”*, Grabovë e Sipërme, Njësia Administrative Lenie, dërgohet bashkëlidhur Kontrata e Sipërmarrjes me Çertifikata e Përkohshme e Marrjes në Dorëzim të Punimeve;
 3. Për investimin *“Rikonstruksioni i urës në qendër të fshatit Grabovë e Sipërme, Njësia Administrative Lenie”* është dërguar Situacioni i Punimeve (blerje e vogël);
 4. Drenazhimi i pellgut në afërsi të Qendrës Shëndetësore Grabovë e Sipërme, Njësia Administrative Lenie, është realizuar, kur u rikonstruktua shkolla. Firmës zbatuese iu kërkua të drenazhonte këtë hapësirë, duke qenë se ishte para shkollës 9-vjeçare *“Koli Baba”*;

Nga informacioni i marrë nga Njësia Administrative Lenie rezulton se banorët e Grabovës furnizohen me ujë të pijshëm nëpërmjet një rrjeti ujësjellësi të ndërtuar nga një shoqatë e huaj para Reformës Territoriale, pra kur Njësia Lenie ishte ende Komunë. Duke qenë se ky fshat ka burime ujore të shumta, çdo familje e ka zgjidhur në mënyrë individuale të gjitha nevojat për ujë duke shfrytëzuar këto burime dhe nuk paguajnë tarifë për ujin e pijshëm.

Në Bashki dhe në Njësinë Administrative nuk është paraqitur asnjë kërkesë për ujë të pijshëm nga ky komunitet. Kanalizimet për ujrat e zeza nuk ekzistojnë në fshatin Grabovë, ashtu si edhe në shumë fshatra të tjerë të Bashkisë Gramsh;

Edhe ndriçimi në ambientet publike të fshatit Grabove nuk është realizuar. Bashkia Gramsh ka gjithësej 93 fshatra, nga të cilat vetëm 10 prej tyre kanë kanalizime të ujrave të zeza dhe vetëm 9 prej tyre kanë ndriçim publik. Njësia Administrative Lenie, ku bën pjesë edhe fshati Grabovë nuk ka asnjë fshat të pajisur me kanalizime të ujrave të zeza dhe asnjë fshat të pajisur me ndriçim publik.

Për sa më sipër, Bashkia Gramsh sqaron se në rastin konkret nuk ka diskriminim por mungesë të mjeteve financiare për të realizuar investime në të gjitha fshatrat e Bashkisë Gramsh, e cila është një bashki e vogël por me territor të gjerë dhe të copëtuar. Fshatrat janë larg njëri tjetrit dhe mungon infrastruktura rrugore. Fatkeqësisht, kjo bashki ka fshatra afër qytetit që u mungon infrastruktura, ndriçimi dhe kanalizimet.

Bashkia Gramsh sqaron se çdo qytetar i saj ka të drejtë të kërkojë investime në fshatin/lagjin e tij, por kjo bashki i shpërndan investimet në atë mënyrë që të preket pak a shumë çdo zonë e Gramshit, normalisht duke marrë në konsideratë edhe numrin e popullsisë që do i shërbejë investimi.

Në lidhje me investimet e kryera në fshatrat fqinjë, pëgjatë tre viteve të fundit është dërguar kopje e Regjistrit të Prokurimeve të Realizuara për viteve 2018, 2019 dhe 2020, nga ku konstatohet se tre vitet e fundit investimet e kryera në Njësinë Administrative Lenie, ku bën pjesë edhe fshati Grabovë janë tre investimet e listuara në pjesën e parë të shkresës. Pra, gjatë 3 viteve të fundit, në Njësinë Administrative Lenie janë kryer investime vetëm në fshatin Grabove e Sipërme dhe asnjë investim në fshatrat përreth këtij fshati.

- Në vijim të shkresës së sipërcituar, KMD iu drejtua Bashkisë Gramsh me shkresën nr. 1622, datë 24.11.2020, ku i kërkohet informacioni i mëposhtëm:

1. Dokumentacion plotësues, lidhur me kryerjen e investimit për rikonstruktimin e urës në qendër të fshatit Grabovë. Përveç situacionit të punimeve, të dërguar nëpërmjet shkresës paraardhëse, të dërgohet pjesa tjetër e dokumentacionit përkatës;
2. Fakte provuese, që vërtetojnë drenazhimin e pellgut me ujë në afërsi të Qendrës Shëndetësore Grabovë;
3. Lista e fshatrave që mbulohen nga Bashkia Gramsh, Njësia Administrative Lenie, të cilët nuk kanë kanalizime të ujrave të zeza, sikurse fshati Grabovë;
4. Lista e fshatrave të tjerë, që mbulohen nga Bashkia Gramsh, të cilëve u mungojnë kanalizimet e ujrave të zeza;
5. Lista e fshatrave të tjerë që mbulohen nga Bashkia Gramsh, të cilët kanë kanalizime të ujrave të zeza;
6. Lista e fshatrave që mbulohen nga Bashkia Gramsh, Njësia Administrative Lenie, të cilëve u mungon ndriçimi i ambienteve publike, sikurse fshatit Grabovë;

7. Lista e fshatrave të tjerë, që mbulohen nga Bashkia Gramsh, të cilëve u mungon ndriçimi i ambienteve publike;
 8. Lista e fshatrave që mbulohen nga Bashkia Gramsh, të cilët kanë ndriçim të ambienteve publike;
- Në përgjigje të shkresës nr. 1622, datë 24.11.2020, së Komisionerit, Bashkia Gramsh dërgoi shkresën nr. 1622/1, datë 09.12.2020, nëpërmjet së cilës sqaron se dokumentacioni plotësues, lidhur me kryerjen e investimit për rikonstruksionin e urës në qendër të fshatit Grabovë është dërguar bashkëlidhur shkresës, ndërkohë që sqarohet fakti se nuk disponohen fakte provuese, që vërtetojnë drenazhimin e pellgut me ujë në afërsi të Qendrës Shëndetësore Grabovë, pasi firma që ka kryer punimet e Shkollës 9-Vjeçare “Koli Baba” e ka kryer vullnetarisht këtë ndërhyrje, pa e patur në projekt dhe nuk është paguar për këtë punë.

Më pas, Bashkia Gramsh ka parashtruar listën e fshatrave që mbulohet nga ky institucion, në Njësinë Administrative Lenie, të cilët nuk kanë kanalizime të ujrave të zeza, sikurse fshati Grabovë, të cilët janë: Lenie, Bicaç, Kuratë, Grabovë Sipër, Grabovë Poshtë dhe Valth.

Lista e fshatrave të tjerë, që mbulohen nga Bashkia Gramsh, të cilëve u mungojnë kanalizimet e ujrave të zeza vijon si më poshtë:

Njësia Administrative Kodovjat ka 9 (nëntë) fshatra pa kanalizime të ujrave të zeza: Bratilë, Bulcarë, Kishtë, Kokël, Posnovisht, Shelcan, Bërsnik i Sipërm, Broshtan, Zamsht. Njësia Administrative Kukur ka 9 fshatra pa kanalizime të ujrave të zeza, si : Kukur, Grazhdan, Gribë, Kalaj, Mukaj, Rashtan, Rmath, Sojnik, Snosëm. Njësia Administrative Kushnovë ka 8 fshatra pa kanalizime të ujrave të zeza, si: Kushovë, Bregas, Sotirë, Ulovë, Gjeraqinë, Dumberas, Bërsnik, Kërpicë. Njësia Administrative Poroçan ka 5 (pesë) fshatra pa kanalizime të ujrave të zeza, të tillë si: Poroçan, Lleshan, Gjerë, Kabash, Holtas. Njësia Administrative Skënderbegas ka 13 fshatra pa kanalizime të ujrave të zeza, si: Skënderbegas, Bletëz, Nartë, Harunas, Ermenj, Vidhan, Fushëz, Kotkë, Kullollas, Lemnush, Shëmbërdhenj, Zenelas dhe Siman. Njësia Administrative Sult ka 9 (nëntë) fshatra ka pa kanalizime të ujrave të zeza, si: Sult, Mazrekë, Dushks, Kutërçarë, Kukuçovë, Zgjuj Kodër, Zgjuj Fushë, Dufshan, Grekan. Njësia Administrative Tunjë ka 12 (dymbëdhjetë) fshatra pa kanalizime të ujrave të zeza si vijnë: Tunjë, Duzhë, Lubinjë, Tunjë e Re, Oban, Plepas, Sarasel, Irmanj, Jançë Mal, Jançë Qendër, Katërlis, Prenjas. Njësia Administrative Pishaj ka 15 (pesëmbëdhjetë) fshatra pa kanalizime të ujrave të zeza, si vijnë: Drizë, Cingar Sipër, Cingar Poshtë, Galigat, Shëmrizë, Ostenth, Gurrëz, Storrë, Liras, Gjergjovinë, Kotorr, Tërvol, Vinë, Fshat Gramsh, Shëmrizë.

Lista e fshatrave të tjerë që mbulohen nga Bashkia Gramsh, të cilët kanë kanalizime të ujrave të zeza është si vijon:

Njësia Administrative Pishaj ka 6 (gjashtë) fshatra, që kanë kanalizime për ujrave të zeza, si: Cërrujë (pjesërisht), Pishaj, Qerret, Cekin, Trashovicë, Kocaj (pjesërisht). Njësia Administrative

Kodovjat ka 3 fshatra të pajisur me kanalizime të ujrave të zeza: Kodovjat, Mashan, Bërsnik. Lista e fshatrave që mbulohen nga Bashkia Gramsh, Njësia Administrative Lenie, të cilëve u mungon ndriçimi i ambienteve publike, sikurse fshati Grabovë janë: Lenie, Bicaj, Kuratë, Grabovë Sipër, Grabovë Poshtë, Valth.

Lista e fshatrave të tjerë që mbulohen nga Bashkia Gramsh, të cilëve u mungon ndriçimi i ambienteve publike janë:

Njësia Administrative Kodovjat ka 9 (nëntë) fshatra, të cilëve u mungon ndriçimi publik, të tillë si: Bratilë, Bulcarë, Kushtë, Kokël, Posnovisht, Shelcan, Bërsnik i Sipërm, Broshtan, Zamsh. Njësia Administrative Kukur ka 8 (tetë) fshatra, që u mungon ndriçimi i ambienteve publike: Kukur, Grazhdan, Gribë, Kalaj, Mukaj, Rashtan, Rmath, Sojnik. Njësia Administrative Kushovë ka 8 (tetë) fshatra, të cilëve u mungon ndriçimi publik, si: Kushovë, Bregas, Sotirë, Ulovë, Gjeraqinë, Dumberas, Bërsnik, Kërpicë. Njësia Administrative Porocan ka 5 (pesë) fshatra, të cilëve u mungon ndriçimi publik, si: Porocan, lleshan, Gjerë, Kabash, Holtas. Njësia Administrative Skënderbegas ka 13 fshatra që u mungon ndriçimi publik, si: Skënderbegas, Bletëz, Nartë, Harunas, Ermenj, Vidhan, Fushëz, Kotkë, Kullollas, Lemnush, Shëmbërdhenj, Zenelas, Siman. Njësia Administrative Sult ka 9 fshatra, që u mungon ndriçimi publik, si: Sult, mazrekë, Dushk, Kutërçarë, Kucucovë, Zgjup Kodër, Zgjup Fushë, Dufshan, Grekan. Njësia Administrative Tunjë ka 12 (dymbëdhjetë) fshatra, të cilëve u mungon ndriçimi publik, si: Tunjë, Duzhë, Lubinjë, Tunjë e Re, Oban, Plepas, Sarasel, Irmanj, Jançë Mal, Jançë Qendër, Katërlis, Prrenjas. Njësia Administrative Pishaj ka 16 (gjashtëmbëdhjetë) fshatra të cilëve u mungon ndriçimi publik, si: Drizë, Cingar Sipër, Cingar Poshtë, Galigat, Shëmrizë, Ostenth, Gurrëz, Storrë, Liras, Gjergjovinë, Kotorr, Tërvol, Vinë, Fshat Gramsh, Shëmrizë, Kocaj.

Lista e fshatrave të tjerë, që mbulohen nga Bashkia Gramsh, të cilët kanë ndriçim të ambienteve publike vijon më poshtë:

Njësia Administrative Pishaj ka 5 (pesë) fshatra të pajisura me ndriçim të ambienteve publike: Cërrijë (pjesërisht), Pishaj (pjesërisht), Qerret, Cekin, Trashovicë. Njësia Administrative Kodovjat ka 3 (tre) fshatra të pajisur me ndriçim të ambienteve publike: Kodovjat, Mashan, Bërsnik. Njësia Administrative Kukur ka një fshat të pajisur me ndriçim të ambienteve publike, i cili është fshati Snosëm.

C. Në vijim të procedurave hetimore, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 18.12.2020, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë u paraqit përfaqësuesja e Bashkisë Gramsh, znj. E. K., Nënkryetare e kësaj bashkie, ndërkohë që Qendra e Konsumatorit Shqiptar nuk dërgoi përfaqësues në këtë seancë, e cila u zhvillua në mungesë të saj.

Përfaqësuesja e Bashkisë Gramsh sqaroi se Grabova është zonë e thellë malore rreth 40 km larg Gramshit. Rruga nuk është shtruar me asfalt, por nga ana e Bashkisë është kryer investim mbi këtë

rrugë dhe ajo është funksionale. Nënkryetarja e kësaj bashkie ndër të tjera sqaroi se rruga Kuratë-Lenie- Grabovë është rikonstruktuar në vitin 2018 dhe banorët nuk janë të izoluar, pasi lëvizin lirisht nëpërmjet saj. Por, ajo theksoi faktin se fondet e Bashkisë Gramsh mjaftojnë vetëm për mirëmbajtje të rrugës, por jo për asfaltimin e saj. Ajo sqaroi gjithashtu se zona e Grabovës është larg Bashkisë Gramsh dhe kjo e fundit nuk e mbulon dot financiarisht. Pamjaftueshmëria e fondeve ka qenë shkak për moskryerjen e investimeve të mëtejshme në infrastrukturë. Në Grabovën e Sipërme jeton minoritet arumun. Ajo u shpreh se shkolla e Grabovës është në gjendje funksionale dhe është rikonstruktuar në vitin 2018. Në Grabovë ndodhen edhe 3 ura me harqe, që janë të vjetra. Për këtë arsye, Bashkia Gramsh i ka kërkuar Ministrisë përgjegjëse të investojë mbi to, pasi këto ura përbëjnë vlerë historike. Ato janë bërë funksionale dhe të kalueshme falë investimeve të Bashkisë Gramsh. Lidhur me çështjen e rrjetit të ujësjellësit, Nënkryetarja e Bashkisë Gramsh theksoi faktin se Grabova është e pasur me burime ujore, që banorët e kësaj zone i përdorin lirisht, por jo nëpërmjet ujësjellësit. Ajo sqaroi gjithashtu se banorët e kësaj zone nuk e paguajnë ujin e pijshëm. Për sa i përket kanalizimeve të ujrave të zeza, ajo sqaroi se ato mungojnë jo vetëm në Grabovë, por edhe në fshatra të tjera. E njëjta gjë vlen edhe për ndriçimin e ambienteve publike. E pyetur mbi mënyrën se si vendosen prioritetet lidhur me kryerjen e investimeve, nënkryetarja e Bashkisë Gramsh u shpreh se përgjithësisht mbështeten tek numri i popullsisë së fshatrave të njësive administrative, por jo vetëm. Njësia Administrative Lenie ka 4 fshatra, ndërkohë që për 3 vitet e fundit janë kryer investime vetëm në zonën e Grabovës. Në fshatrat e tjerë nuk janë kryer investime në rrjetin e ujësjellës kanalizime, të cilët funksionojnë ende në bazë të ujësjellësve të vjetër. Aktualisht, investime për rrjetin e ujësjellësit po kryhen në qytetin e Gramshit. E pyetur nëse banorët e Grabovës kanë depozituar ndonjë ankesë pranë Bashkisë Gramsh, Nënkryetarja e Bashkisë u përgjigj se këta banorë kanë kërkuar rikonstrukcion të rrugës dhe të urës (3 urave me harqe). E pyetur se cilat rrugë janë aktualisht duke u asfaltuar, Nënkryetarja e Bashkisë Gramsh u shpreh se Ministria e Infrastrukturës po zbaton lotin e dytë për asfaltimin e rrugës së Njësies Administrative Skënderbegas.

A. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

Në ankesën nr. 99, datë 18.09.2020, të Qendrës “Konsumatorit Shqiptar” pretendohet diskriminim i banorëve arumunë të Grabovës, për shkak të etnisë, nga ana e Bashkisë Gramsh.

Pretendimi për diskriminim i shoqatës ankuese mbështetet në faktin se Bashkia Gramsh nuk ka kryer investime në infrastrukturën e fshatit Grabovë e Sipërme, si dhe nuk ka përmbushur detyrimet e saj ligjore ndaj banorëve të këtij fshati. Pretendimet e shoqatës kanë lidhje me sa më poshtë vijon:

1. Mungesa e infrastrukturës rrugore, që lidh Lenien me Grabovën;
2. Moskryerja e investimeve në urën që lidh Grabovën dhe Lenien;
3. Mungesa e furnizimit me ujë të pijshëm nëpërmjet sistemit të ujësjellës kanalizimeve;
4. Mungesa e kanalizimeve për ujërat e zeza;
5. Mungesa e ndriçimit në ambienteve publike në fshatin e Grabovës;
6. Ekzistenca e një grope të madhe me ujë para shkollës së Grabovës dhe pranë qendrës shëndetësore në këtë fshat.
7. Moskryerja e investimit në infrastrukturën e shkollës së Grabovës;

Neni 23, i ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” parashikon shprehimisht funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike. Në këtë nen parashikohet se:

Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për:

1. Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.
2. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.
3. Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara.
4. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.
5. Ndriçimin e mjediseve publike;
6. Transportin publik vendor.
7. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit.
8. Shërbimin e dekorit publik.
9. Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.
10. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.
11. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.
12. Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.
13. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
14. Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.”

Për sa më sipër, rezulton se Bashkia Gramsh është përgjegjëse në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, në territorin e juridiksionit të saj. Përgjegjësitë e saj lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm;

ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore; ndriçimin e mjediseve publike; ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar; ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, etj.

Gjatë korrespondencës zyrtare të Komisionerit me Bashkinë Gramsh rezultoi se ky institucion ka kryer disa investime që kanë lidhje me përmirësimin infrastrukturor dhe rikonstruksionin e rrugës Lenie-Kuratë-Grabovë e Sipërme, Njësia Lenie, Shkollës 9-vjeçare Koli Baba”, Grabovë e Sipërme, rikonstruksionin e urës në qendër të fshatit Grabovë e Sipërme, si dhe është kryer drenazhimi i pellgut në afërsi të Qendrës Shëndetësore Grabovë e Sipërme, Njësia Administrative Lenie.

Kryerja e investimeve të mësipërme vërtetohet me aktet e depozituara në cilësi prove nga ana e Bashkisë Gramsh, të tilla si:

1. Kontratë Sipërmarrje nr. 5173, datë 17.08.2018, lidhur ndërmjet Bashkisë Gramsh, në cilësinë e porositësit dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alesjo sh.p.k. dhe Shendëlli sh.p.k., me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Koli Baba” në fshatin Grabovë Sipër, Njësia Administrative Lenie” dhe Çertifikatës së Marrjes së Përkohshme në Dorëzim të Punimeve ku citohet: *“Pas verifikimit të punimeve u konstatua se punimet e ndërtim montimit të këtij objekti janë ndërtuar konform projektit të zbatimit, kontratës dhe kushteve teknike të zbatimit (K.T.Z.) në fuqi. Difekte të mundshme pas kësaj date të riparohen nga kontraktuesi brenda periudhës së garancisë së difekteve”*. Referuar Çertifikatës së Marrjes së Përkohshme në Dorëzim të Punimeve rezulton se data e fillimit të punimeve ka qenë 18.08.2018, data e përfundimit të punimeve ka qenë 18.11.2018 dhe periudha e garancisë së difekteve deri në datën 24.12.2019. Drenazhimi i pellgut në afërsi të Qendrës Shëndetësore Grabovë e Sipërme dhe para shkollës është kryer gjatë kryerjes së punimeve për rikonstruksionin e kësaj shkolle.
2. Kontratë sipërmarrje nr. 4469, datë 09.07.2018 *“Për kryerjen e punimeve në objektin “Rikonstruksion i rrugës Lenie-Kuratë-Grabovë Sipër, Njësia Administrative Lenie”*, lidhur ndërmjet Bashkisë Gramsh në cilësinë e Autoritetit Kontrator dhe operatorit ekonomik “Blerim” sh.p.k., në cilësinë e palës së kontraktuar. Afati maksimal për kryerjen e punimeve është 48 ditë nga dita e lidhjes së kontratës. Referuar Çertifikatës së Përkohshme të Marrjes në Dorëzim të Punimeve rezulton se: *“...Punimet e ndërtimit të këtij objekti janë realizuar konform projektit të zbatimit, kontratës dhe kushteve teknike të zbatimit (K.T.Z.) në fuqi.”* Referuar këtij akti rezulton gjithashtu se punimet kanë filluar në datën 09.07.2018 dhe kanë përfunduar në datën 24.08.2018. Periudha e garancisë së difekteve shkon deri në datën 08.10.2019.

3. Referuar aktit Situacion Punimesh për objektin “*Rikonstruksion i urës hyrëse në fshatin Grabovë*” Bashkia Gramsh, të nëshkruar nga Bashkia Gramsh dhe subjekti realizues “*Illa Ibra*” person fizik, rezulton kryeja e punimeve për rikonstruksionin e kësaj ure.

Përveç sa më sipër, referuar dokumentit “Regjistri i realizimeve të prokurimit publik” për vitin 2018, të autoritetit kontraktor “Bashkia Gramsh” figurojnë edhe dy investimet e para të kryera nga ana e këtij institucioni për rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare “Koli Baba” në fshatin Grabovë Sipër dhe rikonstruksionin e rrugës Lenie-Kuratë-Grabovë Sipër.

Pavarësisht sa më sipër, referuar informacionit të dërguar nëpërmjet shkresave zyrtare të Bashkisë Gramsh rezulton se:

1. Kanalizimet për ujrat e zeza nuk ekzistojnë në fshatin Grabovë;
2. Ndriçimi i ambienteve publike nuk ekziston gjithashtu;
3. Bashkia Gramsh nuk ka ngritur një rrjet ujësjellësi në Grabovë. Banorët e Grabovës furnizohen me ujë të pijshëm nëpërmjet një rrjeti ujësjellësi të ndërtuar nga një shoqatë e huaj para Reformës Territoriale, pra kur Njësia Lenie ishte ende Komunë. Duke qenë se ky fshat ka burime ujore të shumta, çdo familje e ka zgjidhur në mënyrë individuale të gjitha nevojat për ujë duke shfrytëzuar këto burime dhe nuk paguajnë tarifë për ujin e pijshëm.

Lidhur me sa më sipër, Bashkia Gramsh justifikohet me faktin e fondeve të kufizuara që ka në dispozicion, ndërkohë që Komisioneri gjykon se në ditët e sotme, është e pajustificueshme nga ana e këtij institucioni, që të mos i sigurojë banorëve të fshatit Grabovë, nevojat bazike për një jetesë normale, siç janë kanalizimet e ujrave të zeza, ndriçimi i ambienteve publike dhe ndërtimi i një ujësjellësi të përbashkët për këtë zonë. Kryeja e detyrave të mësipërme janë tagër dhe përgjegjësi ekskluzive e Bashkisë Gramsh, e cila përgjatë gjithë këtyre viteve nuk i ka kryer asnjëherë, duke u justifikuar me fondet e kufizuara që disponon.

Në interpretim të nenit 7, pika 1 të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” (i ndryshuar), Komisioneri gjykon se banorët e Grabovës i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Bashkisë Gramsh.

B. Shkaku i mbrojtur “etnia”.

Në ankesën nr. 99, datë 18.09.2020, të Qendrës “Konsumatorit Shqiptar” pretendohet diskriminim i banorëve arumunë të Grabovës, për shkak të etnisë, nga ana e Bashkisë Gramsh.

“*Etnia*” është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen*

familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në rastin konkret, Komisioneri gjykon se “etnia” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme, që e justifikojnë si të tillë. Referuar Raportit të Veçantë të Avokatit të Popullit “Për gjendjen e të drejtave të minoriteteve në Shqipëri” (dhjetor 2014) rezulton gjithashtu se zona e Grabovës banohet nga pakica etnike arumune.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur – etnia.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se banorët e fshatit Grabovë i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Bashkisë Gramsh, pasi këtyre banorëve nuk u janë siguruar nevojat bazë për një jetesë normale, të tilla si rrjeti i ujësjellësit, kanalizimet e ujërave të zeza dhe ndriçimi publik.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore, që i garantohet individit lidhur me shkakun e etnisë, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar.

Për sa më sipër, parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit parashikohet nga Kushtetura e Republikës së Shqipërisë, si dhe nga akte të tjera ligjore, duke sanksionuar njëkohësisht edhe zbatimin e tij nga të gjithë shtetasit shqiptarë. Neni 18, pika 2, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon shprehimisht: *“Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.”*

Njëkohësisht, në referencë të nenit 14, të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut garantohet barazia e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të. Në këtë nen parashikohet shprehimisht: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”* Njëkohësisht neni 1, i Protokollit 12, të kësaj Konvente parashikon se: *“1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër. 2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.”*

Edhe në Direktivën e Këshillit 2004/43/KE të 29 qershorit 2000 “Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike” ndalohet

shprehimisht diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë ndaj të gjithë individëve për shkak të racës dhe përkatësisë etnike.

Në kuptim të nenit 3, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, pakicë kombëtare është një grup shtetasish shqiptarë që banojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, kanë lidhje të hershme dhe të qëndrueshme me shtetin shqiptar, shfaqin karakteristika dalluese kulturore, etnike, gjuhësore, fetare ose tradicionale dhe të cilët janë të gatshëm për të shprehur, ruajtur dhe zhvilluar së bashku identitetin e tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional. Në kuptimin e këtij ligji, pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë janë pakicat greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare. Në nenin 5, pika 2, të ligjit të sipërcituar parashikohet shprehimisht: “Personat, që u përkasin pakicave kombëtare, i ushtrojnë të drejtat dhe gëzojnë liritë e garantuara me këtë ligj, në mënyrë individuale dhe në komunitet me të tjerët, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.”

Në nenin 8, të ligjit nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë” parashikohet: “Ndalohet çdo diskriminim ndaj cilido personi për shkak të përkatësisë së tij/së saj në një pakicë kombëtare. 2. Institucionet publike, qendrore dhe vendore, miratojnë dhe zbatojnë masat e nevojshme: a) për të garantuar barazi të plotë dhe efektive në jetën ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore ndërmjet personave që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës; b) për të mbrojtur personat që u përkasin pakicave kombëtare nga kërcënimet, diskriminimi, armiqësia apo dhuna për shkak të identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional; c) për të forcuar dialogun ndërkulturor;ç) për të nxitur respektin e ndërsjellë, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, pa dallim për sa i përket identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional. 3. Masat e miratuara në përputhje me pikën 2, të këtij neni, nuk përbëjnë akte diskriminimi.”

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion barazie i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi, në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ka si qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për: “a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.

Në nenin 1, të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në nenin 20, pika 1, i LMD parashikohet shprehimisht: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, si vijon: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Kodi i Procedurës Administrative⁴, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Bashkisë Gramsh, e cila duhet të provojnë se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Parimi i ndarjes së barrës së provës është një parim i mirënjohur tashmë në legjislacionin e BE-së dhe KEDNJ. KEDS⁵ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të duhur.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë **se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues**.

Kjo mund të realizohet në njërin nga dy mënyrat e mëposhtme:

⁴ Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

⁵ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

1. Duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore, midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë ose,
2. Duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ekziston një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti kundër së cilit drejtohet ankesa nuk është në gjendje të provojë njëren nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.⁶

Në lidhje me rastin në fjalë, mbështetur në analizimin e fakteve dhe provave të administruara përgjatë hetimit administrativ, si dhe në bazë të rezultateve që dolën nga procedura e shqyrtimit të ankesës, Komisioneri ka vlerësuar se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm të banorëve të fshatit Grabovë, në Njësinë Administrative Lenie, pasi atyre nuk u janë siguruar nevojat bazike për jetesë, të tilla si: rrjeti i ujësjellësit për ujë të pijshëm, kanalizimet e ujrave të zeza dhe ndriçimi i ambienteve publike, të cilat janë tagër dhe përgjegjësi e Bashkisë Gramsh.

Në kushtet kur, Bashkia Gramsh ka patur barrën e provës, ka depozituar prova dhe fakte që vërtetojnë se në fshatin Grabovë e Sipërme janë kryer investime lidhur me rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare “Koli Baba” në fshatin Grabovë Sipër, Njësia Administrative Lenie, mbi drenazhimin e pellgut në afërsi të Qendrës Shëndetësore Grabovë e Sipërme dhe para shkollës së sipërcituar, rikonstruksionin e rrugës Lenie-Kuratë-Grabovë Sipër, si dhe rikonstruksionin e urës hyrëse në fshatin Grabovë.

Mungesën e rrjetit të ujësjellësit të ujit të pijshëm, të ngritur nga ky institucion, Bashkia Gramsh e ka justifikuar me faktin se banorët e Grabovës furnizohen me ujë të pijshëm nëpërmjet një rrjeti ujësjellësi të ndërtuar nga një shoqatë e huaj para kryerjes së Reformës Territoriale, në periudhën kohore kur Njësia Administrative Lenie ishte ende komunë. Bashkia Gramsh nuk ka dhënë informacion se në ç’kushte është ky rrjet ujësjellësi, ç’pjesë të fshatit mbulon, kush kujdeset për mirëmbajtjen dhe klorifikimin e ujit të këtij ujësjellësi etj. Njëkohësisht, Bashkia Gramsh sqaron se fshatarët e Grabovës nuk kanë paraqitur kërkesë me shkrim për ujë të pijshëm, pasi ata e sigurojnë vetë atë, duke përdorur burimet e shumta ujore të Grabovës. Kështu, ata nuk paguajnë tarifë për përdorimin e ujit të pijshëm.

Bashkia Gramsh ka sqaruar gjithashtu se kanalizimet për ujrë e zeza nuk ekzistojnë në fshatin Grabovë, ashtu si edhe në shumë fshatra të tjerë të Bashkisë Gramsh. Ky institucion ka sqaruar se ka në administrim 93 fshatra, nga të cilat vetëm 10 prej tyre kanë kanalizime të ujrave të zeza dhe vetëm 9 prej tyre kanë ndriçim publik. Njësia Administrative Lenie, ku bën pjesë edhe fshati Grabovë nuk ka asnjë fshat të pajisur me kanalizime të ujrave të zeza dhe asnjë fshat të pajisur me ndriçim publik. Bashkia Gramsh ka sqaruar se në rastin konkret nuk ka diskriminim por mungesë të mjeteve financiare për të realizuar investime në të gjitha fshatrat e Bashkisë Gramsh, e cila është një bashki e vogël, por me territor të gjerë dhe të copëtuar. Fshatrat janë larg njëri

⁶ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

tjetrit dhe mungon infrastruktura rrugore. Kjo bashki ka fshatra afër qytetit që u mungon infrastruktura, ndriçimi dhe kanalizimet.

Për sa më sipër, Komisioneri i ka kërkuar informacion të specifikuar dhe konkret Bashkisë Gramsh, për të identifikuar fshatrat që kanë mungesë të kanalizimeve të ujrave të zeza dhe ndriçimit publik, pra që gëzojnë të njëjtin status me fshatin Grabovë e Sipërme, si dhe ato fshatra që aktualisht i kanë të plotësuar këto nevoja. Sipas informacionit të dërguar rezulton se një pjesë të madhe të fshatrave të të gjitha njësive administrative që mbulohen nga Bashkia Gramsh nuk kanë kanalizime të ujrave të zeza, ndriçim të ambienteve publike, si dhe rrjet të ujësujellës kanalizimeve. Në zonën e Grabovës jetojnë banorë që i përkasin pakicës arumune, ndërkohë që në fshatrat e tjerë jeton popullsia, që nuk i përket pakicave kombëtare.

Në këto kushte, Komisioneri gjykon se Bashkia Gramsh, në cilësinë e subjekti që kishte barrën e provës ka provuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore, midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë të banorëve arumunë të Grabovës, pasi edhe në shumë fshatra të tjerë që mbulohen nga kjo bashki ka mungesa infrastrukture, pavarësisht faktin nëse aty banojnë pakica kombëtare ose jo. Gjithashtu, vlen të përmendet fakti se referuar Regjistrin të Prokurimeve të Realizuara për vitet 2018, 2019 dhe 2020, të depozituar në cilësi prove nga Bashkia Grabovë rezulton se fshati Grabovë e Sipërme ka patur investime për shkollën, rrugën Lenie-Kuratë-Grabovë, si dhe për urën e fshatit, ndërkohë që në fshatrat e tjerë të Njesisë Administrative Lenie nuk ka patur investime.

Marrja në vlerësim e fakteve të tilla, krijon bindjen, që trajtimi i disfavorshëm i banorëve të zonës Grabovë e Sipërme nuk ka ardhur si rrjedhojë e përkatësisë së tyre etnike, por si pasojë e mungesës së fondeve për të kryer investime. Në interpretim të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se trajtimi i padrejtë dhe disfavorizues i banorëve të fshatit Grabovë nga ana e Bashkisë Gramsh, nuk ka ardhur për shkak të etnisë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 18, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenit 20, nenit 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nenit 23, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe nenit 3, pikat 1 dhe 2 e nenit 8, të ligjit nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të banorëve të fshatit Grabovë e Sipërme, Njësia Administrative Lenie, për shkak të etnisë, nga Bashkia Gramsh.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha – Shërbime
Shkak – Etnia
Lloji i vendimit - mosdiskriminim